



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



# **Lista Përfundimtare e Votuesve**

## **2010**

## **Qëllimi**

Në bazë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (ligji numër 03/L-073), neni 64.2. KQZ- ja është e obliguar që të *çertifikoj listën e votuesve* në raport me zgjedhjet e caktuara. Ky dokument e mbështetë procesin e çertifikimit të listës së votuesve.

## **Përmbledhje**

Lista Përfundimtare e Votuesve (**LPV 2010**) për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2010 bazohet në Ekstraktin e Regjistrimit Civil ektrakt është përpiluar nga Agjencia për Prodhimin e Dokumenteve (APD), në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

LPV-ja 2010 përmban 1, 630, 636 emra të votuesve të ndarë në 37 Komuna, me një rritje prej 73,288 apo 4,4% në krahasim me zgjedhjet e kaluara. Numri i Qendrave të Votimit (QV) është 746 (ashtu siç ka qenë edhe në zgjedhjet e kaluara), ndërsa numri i vendvotimeve është 2280, me një rritje prej 24 vendvotimeve apo 1.0 % nga zgjedhjet e kaluara.

Gjithashtu Lista e Votuesve jashtë Kosovës 2010 përmban të gjithë votuesit me zotësi juridike të regjistruar suksesshëm. Numri i përgjithshëm i votuesve jashtë Kosovës është 1640. Në krahasim me zgjedhjet e kaluara janë 162 votues më pakë që janë regjistruar për të votuar përmes postës.

## **Përshkrim**

Pas pranimit të ekstraktit të Regjistrimit Civil<sup>1</sup>, ekipi i Shërbimit të Votuesve para se të fillojë alokimin e votuesve në QV ka marrë parasysh disa faktorë që ndikojnë në përgatitjen e Listës së Votuesve. Së pari procesi i decentralizimit<sup>2</sup> dhe krijimi i 7 komunave të reja <sup>3</sup>. Si dhe afatet kohore shumë të ngjeshura dhe të shkurtra që kanë ndikuar në përshpejtimin e procesit të krijimit të listës së votuesve.

Aktivitetet për përgatitjen e Listës së votuesve 2010 kanë vazhduar me caktimin e votuesve të rinj në QV në mënyrë automatike dhe manuale ( Votuesit e vjetër që kanë votuar në mënyrë të rregullt në Qendrat e tyre të votimit nuk janë prekur).

Në vazhdim është bërë caktimit automatik, ndërsa votuesit të cilët nuk kemi mundur t'i caktojmë automatikisht, listat janë dërguar në terren për caktim në mënyrë manuale nga Zyrtarët Ekzekutiv të KKZ-ve. Listat nga terreni që nuk janë finalizu

---

<sup>1</sup> Agjencia për Prodhimin e Dokumentave (APD) në kuadër të Ministrisë për Punë të Brendshme ka larguar 6162 persona të vdekur nga Regjistri Civil, si dhe 917 persona me shenja të gishtërinjëve të dobëta apo të gabuara janë fshirë nga Regjistri Civil/Lista e Votuesve.

<sup>2</sup> Ligji mbi kufijtë e Komunave ( Ligji 03/L-041)

<sup>3</sup> Ka rezultuar me mosaplikimin e ligjit mbi kufijtë e Komunave nga ana e Regjistrimit Civil. Përkatësisht Komunitetet e reja ende nuk posedojnë Qendra Komunale të Regjistrimit Civil dhe kode komunale

janë vlerësuar dhe caktuar manualisht nga Shërbimi i Votuesve. Gjithashtu Shërbimi i Votuesve manualisht ka ricaktu votuesit e komuniteteve tjera në QV të tyre përkatëse.

Pastaj është bërë vlerësimi i votave me kusht të zgjedhjeve të kaluara. Të gjithë votuesit që kanë votuar me kusht brenda komunës së tyre janë caktuar në QV ku kanë votuar për zgjedhjet e kaluara.<sup>4</sup>

Gjithashtu janë inkorporua ndërrimet e adresave nga zgjedhjet e kaluara. Këta votues janë caktuar në qendra të reja të votimit duke u bazuar në adresën e tyre të re.

Vlen të theksohet se një numër i votuesve që kanë ndërruar mbiemrat janë përfshirë me përmirësime në Listën e Votuesve.

Rrjedhimisht, sipas këtij vlerësimi numri i përgjithshëm i kartolinave që iu kanë dërguar votuesve për t'ju konfirmuar qendrën e votimit është 125,461.

Pas një caktimi fillestar të votuesve, kanë pasuar dy periudha të rishikimeve:

#### **Periudha e shërbimit të votuesve**

Të gjithë votuesit kanë pasur mundësi që të kontaktojnë zyrtarët ekzekutiv komunal (nga 10/11 – 16/11 2010) për t'u informuar se në cilën qendër të votimit janë caktuar ose të kërkojnë ri-caktim të qendrës së votimit më të përshtatshme për ta.

Gjatë kësaj periudhe 4000 votues kanë vizituar Zyrët e KKZ-ve, 3200 votues kanë kërkuar ndërrimin e QV ( 91 kanë kërkuar direkt në zyrën e shërbimit të votuesve). Nga këto kërkesa janë refuzuar vetëm 328 për arsye si në vijim:

- a). Sepse Qendra e kërkuar nuk bënë pjesë në komunën e njëjtë,
- b). Nuk kanë ofruar dokumente të vlefshme të identifikimit,
- c). Kanë aplikuar më shumë se një herë.

Votuesit vazhdimisht kanë pasur mundësi të konfirmojnë qendrën e tyre të votimit në webfaqen e KQZ-së. Gjatë kësaj periudhe makinën kërkuese e kanë vizituar 10213 persona.

Pas kësaj periudhe, zyra për shërbim të votuesve ka vendosur të gjitha ndryshimet në listën e votuesve e cila më pas është integruar në ekstraktin e pranuar nga APD-ja.

Bazuar në këto të dhëna, zyra për shërbimin e votuesve ka krijuar listën e përkohshme të votuesve (LPV). LPV-ja ka qenë prezantimi i parë publik i listës së votuesve e cila do të përdoret për këto zgjedhje.

---

<sup>4</sup> Votuesit që kanë votuar me kusht dhe që kanë qenë anëtarë të KVV-e nuk janë inkorporu

Ky dokument i është dërguar KKZ-ve dhe ka qenë i postuar në faqen e internetit të Sekretariatit të KQZ-së. Gjithashtu, CD me kopje të LPV-së kanë qenë të përgatitura dhe i janë shpërndarë subjekteve politike dhe kanë qenë në dispozicion të vëzhguesve.

### **Periudha e kundërshtimit dhe Konfirmimit**

Periudha e Kundërshtimit dhe Konfirmimit (nga 22/11 – 26 Nëntor 2010 ) i ka mundësuar të gjithë votuesve që të sfidojnë LPV-në. Pas periudhës së Kundërshtimit dhe Konfirmimit, zyra e Shërbimit të Votuesve ka pranuar 4 vendime të gjykatës Komunale. Prej tyre dy vendime kanë urdhëruar largimin e 3 personave të vdekur nga Lista e Votuesve, ndërsa 2 vendime kanë vërtetuar kërkesën për ndërrimin e QV.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe regjistri Civil ka larguar 14 persona të vdekur nga Regjistri Civil.

### **Krijimi i LPV-së**

Pas gjithë këtyre fazave, Zyra për Shërbim të Votuesve i ka klasifikuar votuesit nëpër QV, si dhe i ka ndarë në vendvotime sipas alfabetit. Të dhënat e reja janë shtypur në format PDF dhe kualiteti është kontrolluar nga ana e zyrës për Shërbim të Votuesve. Këto dokumente janë të gatshme për t'ju dërguar kompanisë e cila do ta bëjë shtypjen përfundimtare të LPV-së 2010.

### **Votimi përmes Postës**

Programi i votimit me Postë është ndërmarrë në mes 5/11- 16/11/2010, ashtu siq përcaktohet me rregullën Nr.15 të KQZ mbi zgjedhjet e parakohshme/jashtëzakonshme. Njësia e Shërbimit të votuesve ka dërguar 2546 formular dhe të gjitha materialet e nevojshme informuese votuesve të zgjedhjeve të kaluara në 26 shtete. Po ashtu 900 Formular për regjistrim dhe materiale informuese janë dërguar edhe tek 45 pikat shpërndarëse në 24 shtete. Informatat e nevojshme dhe formulari janë publikuar në webfaqen zyrtare të KQZ-së.

Deri në përfundim të periudhës së regjistrimit kemi pranuar 5015 aplikacione. Prej tyre janë aprovuar 1640 votues, ndërsa janë refuzuar 3228. Ndërsa 147 aplikacione kanë qenë të dyfishta.

Numri i përgjithshëm i votuesve në listën e Votuesve jashtë Kosovës është:1640

## **Përmbledhje në lidhje me votuesit**

### **1.1 Numri i Përgjithshëm i Votuesve në LPV 2010 - 1630636**

- **Votues të rinjë: 73288 ose 4.4%**
  - **Votues që mbushin 18 vjetë – 35735 ose 2.19 %**
- **Kanë ndryshuar adresën: 34521 ose 2.11 %**
- **Numri i personave të vdekur të largua nga Lista e Votuesve- 6165**
- **Numri total i kartolinave informuese - 125461**

## **Rekomandimet për regjistrin Civil**

Njësia e Shërbimit të Votuesve është e kënaqur dhe e vlerëson bashkëpunimin e ngushtë dhe profesional me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Lidhur me proceset e ardhëshme të krijimit të Listës së Votuesve ofronë këto rekomandime:

- Të vazhdohet me pastrimin e Regjistrit Civil nga personat e vdekur
- Ngritjen e cilësisë së adresave të votuesve
- Shqyrtimin dhe përmirësimin e P-kodeve të të regjistruarëve
- Të sigurohet dhe të mundësohet që qytetarët të kenë qasje në zyret e regjistrimit civil në tërë Kosovën

**Përmbledhje:**

- 1. Numri i përgjithshëm i votuesve 2010 – 1630636**
- 2. Numri i votuesve për Komuna dhe Numri i Qendrave të Votimit dhe Vendvotime**

<b>Komuna</b>	<b>Numri i Votuesve</b>	<b>Numri i QV</b>	<b>Numri i VV</b>
1 - Deçan/Deçani	<b>37244</b>	8	49
2 - Gjakovë/Đakovica	<b>97215</b>	28	129
3 - Glllogovc/Glogovac	<b>46657</b>	20	59
4 - Gjilan/Gnjilane	<b>87387</b>	28	122
5 - Dragash/Dragaš	<b>36658</b>	28	53
6 - Istog/Istok	<b>40778</b>	15	55
7 - Kaçanik/Kaçanik	<b>30308</b>	16	42
8 - Klinë/Klina	<b>38705</b>	16	53
9 - Fushë Kosovë/Kosovo Polje	<b>28105</b>	9	37
10 - Kamenicë/Kamenica	<b>35381</b>	25	51
11 - Mitrovicë/Mitrovica	<b>86834</b>	32	126
12 - Leposavić/Leposaviq	<b>16730</b>	17	30
13 - Lipjan/Lipljan	<b>50374</b>	26	71
14 - Novobërdë/Novo Brdo	<b>7936</b>	18	19
15 - Obiliq/Obilić	<b>21313</b>	14	32
16 – Rahovec/Orahovac	<b>49321</b>	34	71
17 – Pejë/Peć	<b>93721</b>	23	122
18 – Podujevë/Podujevo	<b>75636</b>	43	107
19 – Prishtinë/Priština	<b>161236</b>	56	220
20 – Prizren/Prizren	<b>144579</b>	60	204
21 – Skenderaj/Srbica	<b>49320</b>	32	70
22 – Shtime/Štimlje	<b>22313</b>	10	32
23 – Štrpce/Shtërpçë	<b>12604</b>	9	18
24 – Suharekë/Suva Reka	<b>57617</b>	30	80
25 – Ferizaj/Uroševac	<b>91876</b>	25	122
26 – Viti/Vitina	<b>42882</b>	26	58
27 – Vushtrri/Vučitrn	<b>63300</b>	24	90
28 – Zubin Potok/Zubin Potok	<b>7563</b>	12	15
29 – Zvečan/Zveçan	<b>8475</b>	6	13
30 – Malishevë/Mališevo	<b>44089</b>	29	65
31 – Juniku/Junik	<b>5191</b>	1	7
32 – Mamusha/Mamuša	<b>3112</b>	1	4
33 – Hani I Elezit/Đeneral	<b>7943</b>	4	12
34 – Graçanica/Graçanica	<b>16825</b>	10	25
35 – Ranilug/Ranillugu	<b>4929</b>	3	7
36 – Parteshi/ Parteš	<b>3694</b>	3	5
37 - Klokot/Kllokoti	<b>2785</b>	5	5
<b>TOTAL:</b>	<b>1630636</b>	<b>746</b>	<b>2280</b>

